		Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Sistemi Qendror Bankar	WAN, LAN
		Union Bank	<i>Oracle FCUBS 11.3</i>	WAN, LAN
		Raiffeisen Bank sh.a.	<i>Core Banking System</i>	WAN, LAN
		Banka e Parë e Investimeve	<i>Core Banking System</i>	WAN, LAN
		Banka Credins	<i>Core Banking System</i>	WAN, LAN
		Banka Tirana	Sistemi Qendror Bankar	WAN, LAN
		ProCredit Bank	Sistemi Qendror Bankar	WAN, LAN
		Banka Amerikane e Investimeve	Sistemi Qendror Bankar	WAN, LAN



	Mikrofinanciar	SHKK “FED invest”	Sistemi Qendror	
		IuteCredit		WAN, LAN
	Tatimet	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Sistemi <i>e-Tax</i>	
			Pajisja fiskale (<i>Nexus</i>)	
Transporti	Ajror Detar Rrugor	Albcontrol sh.a.	Sistemi Kombëtar i Shërbimit të Navigimit Ajror	
		Autoriteti Portual Durrës	Sistemi i kontrollit të regjimit hyrje- daljeve në Portin Durrësit	
			Sistemi i menaxhimit të terminalit të kontejnerëve (TOS)	
			Sistemi VMS i kamerave në territorin e Portit Durrës	
		Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	Sistemi <i>eDM</i>	
			Sistemi <i>eDPSHTR</i>	
Qeveritar		Ministria e Mbrojtjes/Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura	Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIHVD)	
			Pikat e Ritransmetimit (PRT), infrastrukturë mbështetëse e Sistemit të radio-komunikimit të FA-së	Rrjet i pikave të ritransmetimit dhe infrastruktura mbështetëse e radio-komunikimit
			Mjediset e transmetimit të zotëruara nga AKSHI, të cilat sigurojnë komunikim dhe transmetim të dhënash	
			Qendra e ndërlidhjes e ndërtuar në Komandat e Forcave	
			Qendra e ndërlidhjes së MM/SHPFA	
			Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore (SIVHA)	
			Qendrat e Komunikim-Komandim-Kontrollit në FA	Infrastruktura Mbështetëse
			Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI) në MM/SHPFA	LAN/WAN
			Sistemet dhe Infrastruktura lokale ICT e dhomës së serverëve në Ministrinë e Mbrojtjes	LAN
			Agjencia e Zhvillimit të Territorit	Sistemi Multifunksional i Qendëruar i Lejeve të Ndërtimit
				Platforma Qeveritare e Ndërveprimit



		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Portali Qeveritar e-Albania	Infrastruktura e Rrjetit GovNet
			Infrastruktura e Çelësave Publik (PKI) <i>Microsoft Exchange</i>	
			<i>Active Directory</i>	
		Instituti i Sigurimeve Shoqërore	PCAMS (<i>Pension Calculation and Management Systems</i>)	LAN
			CMIS (<i>Contribution and Management Information Systems</i>)	
			Dmais (<i>Document Management And Archiving Information Systems</i>)	
		Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Sistemi i administrimit të pronësisë industriale	
		Agjencia Shtetërore e Kadastrës	Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme (<i>ALBSRep</i>)	
		Qendra e Shërbimeve Arsimore	Sistemi Elektronik i Vlerësimit të Maturës Shtetërore	
			Regjistri Kombëtar i Studentëve	
			Sistemi i Provimeve të Shtetit	
			Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar	
		Qendra Kombëtare e Biznesit	Regjistri i biznesit (<i>e-regjistr</i>)	
			Regjistri i lejeve, licencave dhe autorizimeve (<i>e-licencing</i>)	
		Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Infrastruktura totale e Sistemit RKGJC	
			Infrastruktura totale e Sistemit RKA	
			Infrastruktura e Arkivës së Gjendjes Civile	



			Infrastruktura e Ndërfaqes së Komunikimit midis RKA-së dhe RKGJC-së	
			Infrastruktura e Rrjetit të Komunikimit midis DPGJC-së dhe ZGJC-ve	
		Agjencia e Prokurimit Publik	Sistemi i Prokurimit Publik	
		Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Vërtetimi Elektronik i Gjendjes Gjyqësore	
		Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Sistemi elektronik i lejeve të fluturimit - Për Autoritetin e Aviacionit Civil	
		Departamenti i Administratës Publike	HRMIS	
		Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Sistemi i Shërbimeve të Punësimit	
		Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	Sistemi i Menaxhimit të Standardeve (SMS)	
		Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore	
Infrastruktura Digjitale	-	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Sistemi i Menaxhimit Cctld.Al	
			Sistemi i Bazës së të Dhënave të Centralizuar të Portabilitetit të Numrit (CrdB)	
			Sistemi i menaxhimit të Aplikimeve dhe Raportimeve Online (RevZone)	
			Sistemi i menaxhimit/monitorimit të frekuencave	



Shtojcë 2

LISTA E INFRASTRUKTURAVE TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

SEKTORI	NËNSEKTORI	OPERATORI ADMINISTRUES	SISTEMI RËNDËSISHËM	RRJET I RËNDËSISHËM		
Shëndetësor		Spitali “Continental”	<i>e-DOCTOR</i>			
		Villa Maria	Financa 5			
		Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Moduli i Depove Farmaceutike (<i>e-Depo</i>)			
			Formulari i vizitave të mjekut (<i>e-Vizita</i>)			
Financiar	Mikrofinanciar	<i>Agro&Social Fund</i> sh.p.k	Sistemi Financiar			
		Fondi Besa sh.a.	Sistemi Financiar			
	Tatimet	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Sistemi Mobile (<i>m-Tax</i>)			
		Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Sistemi i Regjistrit të Shitjeve të Kontratave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik			
			Sistemi i Regjistrit të Dëmeve			
			Sistemi i Raportimit Financiar SRF për Fondet			
			Sistemi AMF InReg për raportimin e Tregut të Sigurimeve			
	Tregu i Siguracioneve	Sigal		SIAC – Sistemi i shitjes		
				Sistemi i Regjistrit të Dëmeve ICA		
				SAP – Sistemi Financiar		
		Atlantik		EduSoft – Sistemi i shitjes		
				EduSoft - Sistemi i Regjistrit të Dëmeve		
				Financa 5 - Sistemi Financiar		
		Albsig		EduSoft – Sistemi i shitjes		
				EduSoft - Sistemi i Regjistrit të Dëmeve		
				EduSoft - Sistemi Financiar		
		EuroSig		EduSoft – Sistemi i shitjes		
				EduSoft Edusoft (<i>e-insure</i>) - Sistemi i Regjistrit të Dëmeve		
				EduSoft - Sistemi Financiar		
		Insig		Edusoft (<i>e-insure</i>) – Sistemi i shitjes		
				Edusoft (<i>e-insure</i>) - Sistemi i Regjistrit të Dëmeve		
				Edusoft (<i>e-insure</i>) - Sistemi Financiar		
					Edusoft (<i>e-insure</i>)- Sistemi i shitjes	
					Edusoft (<i>e-insure</i>)- Sistemi i shitjes	



		Ansig	Regjistrit të Dëmeve	
			Financa 5 - Sistemi Financiar	
		Intersig	MBA – Sistemi i shitjes	
			MBA- Sistemi i Regjistrit të Dëmeve	
			SAP - Sistemi Financiar	
		Sivig	MBA – Sistemi i shitjes	
			MBA- Sistemi i Regjistrit të Dëmeve	
			SAP - Sistemi Financiar	
Transporti	Detar	Autoriteti Portual Durrës	Sistemi i pagave të Autoritetit Portual Durrës	
Qeveritar		Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Sistemi informatik i integruar për shërbimet për licencimin VPP, pranë MZHU-së	
			Sistemi informatik i integruar për shërbimet për licencimin në studim, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pranë MZHU-së	
			Arkiva Digjitale e AQTN-së (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit)	
			Sistemi WEB-GIS në Autoritetin Rugor Shqiptar (Autoriteti Rugor Shqiptar)	
			Sistemi i Menaxhimit të Trafikut (Autoriteti Rugor Shqiptar)	
			Sistemit të Menaxhimit të Trafikut (vazhdimi) dhe Instalimi i Sensorëve peshë për Aks (Autoriteti Rugor Shqiptar)	
			Sistemi i Menaxhimit të Kontratave, Inspektimi dhe Raportimi (Autoriteti Rugor Shqiptar)	
		Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Sistemi Informatik Financiar Qeveritar	
			Sistemi Financiar i Borxhit	
		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	<i>e-Aktet</i>	
			<i>Electronic Record Document Management System (ERDMS)</i>	
		Agjencia e Trajtimit të Pronave	Baza e të dhënave për Sistemin ATP-WEBGIS për trajtimin e pronave	
		Qendra e Botimeve Zyrtare	Sistemi i Arkivit të Akteve të Qendrës së Botimeve Zyrtare	
		Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shërbimi Konsullor Online	
		Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura		Sistemi i Fibrës Optike në Forcat e Armatosura
			Sistemi i Menaxhimit	



		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Financiar AlphaWeb	
			Sistemi Elektronik i Monitorimit të Pyjeve	
			Sistemi Pasaporta Digjitale	
			Sistemi Raportimit të Ajrit (Raven)	
			Sistemi e-lege, për VNM	
		Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor	Gjeoportali Kombëtar	
		Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Menaxhimi i Informacionit të Sistemit Penitenciar (Menaxhimi i Kartelave të të Dënuarve)	
		Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	Sistemi Informatik Kombëtar i Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore	
Infrastruktura Digjitale		Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Mësues për Shqipërinë	
		Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Regjistri Elektronik i Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (Atlas)	

VENDIM**Nr. 555, datë 15.7.2020**

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE PËRPARËSITË PËR AKORDIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 janarit të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët, pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin për t’u planifikuar në buxhetin e vitit pasardhës.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin brenda muajit mars planifikon nevojat për fonde për grante të menjëhershme për vitin pasardhës të buxhetit të shtetit, bazuar në kërkesat vjetore të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

3. Me miratimin e ligjit për buxhetin e shtetit të vitit pasardhës, njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet ministrisë përgjegjëse për strehimin

kërkesat për çeljen e fondeve të planifikuara në vitin korrent, shoqëruar me kostot financiare për familje sipas formularit të shtojcës “A”, bashkëlidhur këtij vendimi, pasi ka verifikuar:

a) të dhënat e kontratës me subjektin, me të cilin individi/familja ka lidhur kontratën e kreditimit ose kontratën e shitblerjes së banesës me kosto të ulët;

b) faktin nëse individi/familja ka përfituar më parë nga programe për dhënie granti apo nga zbritje të vlerës së banesës, për shkak të statusit të familjes ose të ndonjë prej anëtarëve të saj.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas çeljes së fondit nga ministria përgjegjëse për strehimin dhe në varësi të formës së përfitimit të banesës me kosto të ulët nga familja/individi, akordojnë fondet në favor të:

a) kryefamiljarit/es që ka lidhur kontratë shitblerjeje me një subjekt ndërtues publik ose privat;

b) institucionit publik që ka siguruar banesën me kosto të ulët, vlerën e të cilit familja e shlyen me këste mujore;

c) institucionit financiar që ka akorduar kredinë sipas një marrëveshjeje të nënshkruar midis tij dhe subjekteve shtetërore, sipas nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me qëllim reduktimin e kësteve mujore që paguan individi/familja.



5. Nga kategoritë e parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, për përfitimin e grantit të menjëhershëm përfitojnë me përparësi:

- a) kryefamiljarët me aftësi të kufizuara;
- b) familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara;
- c) individët me statusin e jetimit, të cilët jetojnë në banesa të papërshtatshme ose në konvikte;
- ç) individët me statusin e jetimit që kanë në ngarkim vëllezër dhe motra, të papunësuar;
- d) kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje;
- dh) familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian;
- e) familjet/individët të parashikuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që kanë rënë në vështirësi financiare dhe që rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi.

6. Në rastet e parashikuara në shkronjën “e”, të pikës 5, të këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore mbështet familjen/individin, që ka rënë në vështirësi financiare, duke siguruar financimin e grantit të menjëhershëm në një kohë sa më të shpejtë dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës për grantin e menjëhershëm. Për marrjen e këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore bazohet në:

- a) vërtetimin për gjendjen financiare të krijuar për familjen/individin dhe shkaqet që kanë sjellë vështirësinë financiare të krijuar;
- b) informacionin e nevojshëm të marrë nga institucioni që ka kredituar familjen/individin për pamundësinë e shlyerjes së kredisë, për shkak të gjendjes së vështirë financiare;
- c) vërtetimin nga institucioni që ka kredituar familjen/individin se shuma e grantit është e mjaftueshme për të lehtësuar pagesat e kredisë.

7. Përparësitë, sipas pikës 5, të këtij vendimi, shërbejnë për përshpejtimin e afatit kohor të livrimit të grantit dhe nuk përjashtojnë përfitimin nga granti i menjëhershëm i kategorive të familjeve/individëve, të parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që nuk kanë një nga karakteristikat e pikës 5, të këtij vendimi.

8. Për përfitimin e grantit të menjëhershëm, familja/individit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kritereve dhe procedurave

të përcaktuara në vendimin nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

9. Dokumentet sipas pikës 8, të këtij vendimi, si edhe çdo akt apo dokument që vërteton njërin prej situatave të parashikuara në pikën 5 të këtij vendimi, dorëzohen vetëm atëherë kur ato apo njëra prej tyre nuk janë dorëzuar gjatë aplikimit dhe përfitimit të banesës me kosto të ulët.

10. Familjet/individët sipas kategorive të përcaktuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si rregull paraqesin kërkesën për përfitimin e grantit të menjëhershëm pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore së bashku me kërkesën për t’u trajtuar me banesë me kosto të ulët.

11. Përjashtimisht, kur familja/individit që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” e “b”, të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që ka përfituar banesë me kosto të ulët në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, si edhe kur ka përfituar banesë me kosto të ulët me fondet e planifikuara për periudhën 2018 dhe 2019 dhe është në një marrëdhënie kontraktore me një institucion publik ose privat për shlyerjen e kredisë apo të vlerës së banesës, por nuk ka mundur të përfitojë grantin e menjëhershëm apo kur i është krijuar statusi i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, pasi ka përfituar banesën me kosto të ulët, mund të paraqesë kërkesë për përfitimin e grantit të menjëhershëm pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore në çdo kohë, së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton statusin. Këto familje/individë e përfitojnë grantin e menjëhershëm, sipas parashikimeve të pikës 10, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

12. Lista e përfituesve, e cila hartohet nga zyra përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas dokumentacionit përkatës, vlerësohet nga struktura përgjegjëse për strehimin dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

13. Vendimi nr. 527, datë 6.8.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për përfitimin e grantit të



menjëhershëm për banesat me kosto të ulët”, shfuqizohet.

14. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për strehimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA A

TABELA E PARAQITJES SË KËRKESËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE NË MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR STREHIMIN PËR GRANT TË MENJËHERSHËM

Nr.	Emër Mbiemër	Kontrata e lidhur me (p.sh. EKB ose Banka xx)	Vlera e shitblerjes sipas kontratës	Shuma e grantit që kërkohet nga buxheti (4 x 10%)
1	2	3	4	5

VENDIM

Nr. 557, datë 15.7.2020

PËR DHËNIEN E KONTRIBUTIT FINANCIAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR KËSHILLIN KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI, PËR BLERJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e kontributit financiar, në shumën 40 000 (dyzet mijë) euro ose kundërvlerën e saj në lekë, për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për t’u përdorur për blerjen e teksteve shkollore për shkollat shqipe në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje.

2. Kundërvlera në lekë e shumës së sipërpërmendur të transferohet në formën e transfertës në llogari të përfituesit, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të

përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në programet buxhetore “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, “Sporti” dhe “Rinia”.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 558, datë 15.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 23.6.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE ‘PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËVE’, SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Qendra Kombëtare Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve” zëvendësohet me “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.1 Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është institucion që ofron shërbime të shëndetit mendor, në lidhje me diagnostikimin, trajtimin, kujdesin terapeutik dhe rehabilitimin e aftësisë së kufizuar për fëmijët.

2.2 Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

2.3 Shërbimet ofrohen nga ekipe multidisciplinare të përbëra nga specialistë të disa fushave, si: mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi, ergoterapistë, fizioterapistë, terapistë psikomotorë dhe specialistë të tjerë të profilit mjekësor, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas roleve dhe përgjegjësi të përshkruara në rregulloren e brendshme të institucionit.

2.4 Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, udhërrëfyesit dhe standardet e kujdesit shëndetësor e social miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.”.

II. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 560, datë 15.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË
SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME
LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM,
MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË
PASURITË KULTURORE, PËR
KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE
PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Institucioni/autoriteti kontraktor, që disponon fondin publik për hartimin e projektit të ndërhyrjes, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuri kulturore, fillon procedurat e konkurrimit publik, me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Konkurrimit (në vijim Komisioni).”.

b) Shkronja “f”, e pikës 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

“f) të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse të projektimit, të zbatimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuritë kulturore, deri në masën 50% të vlerës së fondit limit të procedurës së konkurrimit.”.

c) Në fund të pikës 22 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e procedurave të konkurrimit për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, kriteri i përcaktimit të ofertës fituese është oferta ekonomikisht më e favorshme.”.

ç) Pas pikës 22 shtohen pikat 22/1, 22/2 dhe 22/3, me këtë përmbajtje:



“22/1. Pas hapjes së ofertave, Komisioni mund të anulojë procedurën, në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë ofertë;
- b) nuk është kualifikuar asnjë ofertë e vlefshme;
- c) ofertuesi/ofertuesit i/e kualifikuar tërhiqen para lidhjes së kontratës ose nuk pranon/jnë të bëj/në sigurimin e kontratës;

ç) për arsye dhe shkaqe që nuk varen nga vullneti i institucionit/autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës.

Komisioni nuk mban përgjegjësi për vendimin e marrë, në bazë të kësaj pike, ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta. Vendimi u komunikohet të gjithë ofertuesve, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij, bashkë me arsyet. Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit të anulimit bëhet njoftimi në të njëjtën mënyrë siç është bërë edhe njoftimi i kontratës.

22/2. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

22/3. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.”

d) Pas pikës 23 shtohet pika 23/1, me këtë përmbajtje:

“23/1. Procedurat përzgjedhëse të subjekteve të pajisura me licencë për projektim janë procedura konkurrimi me faza.”

dh) Në pikën 24, pas fjalëve “... të këtij vendimi” shtohen fjalët “... me përjashtim të rasteve kur procedura e konkurrimit zhvillohet nga organi i vetëqeverisjes vendore, në administrimin e të cilit ndodhet pasuria kulturore”.

2. Pas pikës 10, të kreut III, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. Në rastin e zhvillimit të procedurave të konkurrimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, vendimi i marrë nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor, sipas pikës 3 të këtij kreu, është përfundimtar nga ana administrative.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 564, datë 16.7.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE, PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, SI DHE PËR TRAJTIMIN E PERSONELIT MJEKËSOR NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 4, që përmendet në pikën 13, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin “Struktura dhe nivelet e pagave, për mjekët me tituj e grada shkencore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 mars 2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore

Kualifikimi/Grada/Titulli Shkencor	Paga bazë mujore (lekë/muaj)	Shtesa për kushte pune (lekë në muaj)
1	2	3
Shef shërbimi nga kategoria “Profesor”	123.800	8600
Shef shërbimi nga kategoria “Docent”	106.700	7400
Profesor	121.000	8500
Profesor i asociuar	105.200	7300
Docent	95.800	6700

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë